



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës Jugore
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

Spektori i Kulturës

Mitrovicë, 15.09.2026

FTESË PUBLIKE PËR PROJEKTET KULTURORE PËR OJQ TË VITIT 2026 (Thirrja e Parë)

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport/Spektori i Kulturës duke u bazuar në RREGULLOREN MF - NR – 04/2017 MBI KRITERET, STANDARDET DHE PROCEDURAT E FINANCIMIT PUBLIK TË OJQ-VE i fton organizatat e regjistruara si **OJQ** (sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi për lirinë e asocimit në organizata jo-qeveritare në Republikën e Kosovës), **e me bazë në Mitrovicë**, programi i të cilave është i fokusuar në fushën e kulturës, që të aplikojnë për mbështetje financiare për projektet-idetë me karakter:

- Profesional, të cilat me kualitetin e tyre formal dhe përmbajtjesor i respektojnë standardet krijuese evropiane dhe botërore;
- Aktivitete kulturore
- Tradicional, përmes të cilave do të promovohen vlerat kulturore;
- Inovativ, të cilat me formën, përmbajtjen, frymën dhe mënyrën e realizimit të tyre paraqesin risi për ambientin krijues;

2. OJQ-të, në përputhje me këtë ftesë publike mund të aplikojnë me projektet/programet e tyre për promovimin e kulturës, në fushën e *muzikës, teatrit, arteve vizuale*.

3. Vlera totale e planifikuar e ftesës për Lot 1 është **15,000.00 Euro**

- Shuma minimale e mbështetjes financiare për OJQ-të që mund të alokohet për çdo projekt është 5,000.00 **Euro**, ndërsa shuma maksimale është 15,000.00 **Euro**.

4. Vlera totale e planifikuar e ftesës për Lot 2 është **35,000.00 Euro**.

- Shuma minimale e mbështetjes financiare për OJQ-të që mund të alokohet 2,000.00 **Euro** ndërsa shuma maksimale është 5,000.00 **Euro**.

4. Afati i fundit për dorëzimin e propozimeve është 15 ditë dhe përfundon me datën **05.10.2026**.

5. Kriteret administrative për OJQ-të:

Për t'u kualifikuar për mbështetje financiare publike, aplikuesit duhet të plotësojnë kriteret administrative të përcaktuara me dispozitat në vijim:

- të jenë të regjistruar si OJQ sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi për lirinë e asociimit në organizata jo-qeveritare në Republikën e Kosovës apo në shtetin ku është e koncentruar diaspora;
- të jenë të pajisur me numër fiskal sipas kërkesave të legjislacionit tatimor të Republikës së Kosovës, përkatësisht dokumentacionin ekuivalent sipas legjislacionit të shtetit përkatës për OJQ-në e huaj;
- të kenë kryer të gjitha detyrimet nga mbështetja financiare paraprake, nëse kanë përfituar nga burimet publike të financimit;
- të mos kenë pranuar mjete nga burime tjera të financimit për të njëjtat aktivitete; dhe
- të mos ekzistojë ndonjë konflikt interesi në mes të aplikuesit, përkatësisht përfaqësuesve/udhëheqësit të aplikuesit dhe organizatës buxhetore apo institucionit publik, siç parashihet me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës.
- Vërtetimin që OJQ-ja nuk ka obligime tatimore (nga ATK). Obligative
- OJQ-ja duhet të paraqesin prova se personi përgjegjës në OJQ nuk është nën hetime për vepra penale (**Mund të bashkëngjitet para nënshkrimit të kontratës**).
- **Veprimtarinë e organizatës ta ushtrojnë ne qytetin përkatës të thirrjes.**
- Konfirmimin bankar (jo më të vjetër se 6 muaj).

Në rast të dështimit për të përmbushur ndonjërin nga kriteret specifike, aplikacioni do të konsiderohet i pa kompletuar dhe si i tillë nuk do të kualifikohet për mbështetje financiare.

-6. Kriteret përmbajtjesore të vlerësimit:

Me rastin e vlerësimit të projekt-propozimeve, Komisioni do të vlerësojë me sa vijon:

- a posedon OJQ-ja, kapacitete profesionale për të kryer aktivitetet e planifikuara të projektit /programit (a kanë aftësitë e duhura dhe aftësitë për zbatimin e projektit, si dhe njohuri në lidhje me çështjet që trajtohen në këtë ftesë)
- a posedojnë kapacitete të menaxhimit të mjaftueshme OJQ-ja (duke përfshirë personelin, pajisjet për të udhëhequr me projektin)?
- a është i përcaktuar ekipi i projektit dhe detyrimet e anëtarëve të ekipit?
- sa relevant është projekt-propozimi për qëllimet dhe fushat të ftesës publike (a ndërlidhet projekti me aktivitetet e parapara me politikat e fushës, të cilat i mbulon ftesa publike?
- a janë objektivat e projektit/programit të përcaktuara në mënyrë të qartë dhe realisht të arritshme?
- a janë aktivitetet e projektit / programit të qarta, të arsyeshme, të kuptueshme dhe të zbatueshme?
- a janë kostot e projektit/programit reale në lidhje me rezultatet specifike dhe kohëzgjatjen e pritshme të projektit?
- a janë kostot e projektit në përputhje me aktivitetet e planifikuara të projektit/programit?
- Portofolie e Ojq-së për aktivitetet e tyre ?

OJQ-të mund të aplikojnë me më së shumti **(1)** projekt në kuadër të kësaj ftese publike.

Periudha e zbatimit të projektit është më së largu **3 muaj** nga dita e nënshkrimit të kontratës.

Të drejtë aplikimi me projektet e tyre kanë OJQ-të që dëshmojnë se programi i tyre i punës është i fokusuar në fushën e promovimit të kulturës. OJQ-të duhet po ashtu të kenë kryer transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit në fuqi, në përputhje me rregullat e kontabilitetit, si dhe të kenë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj ofruesit të mbështetjes financiare dhe të gjithë ofruesve tjerë të mbështetjes financiare publike.

Propozimet do të dorëzohen vetëm në **formularët e paraparë**, të cilat së bashku me Udhëzimet për Aplikantët, janë në dispozicion në web-faqen e Komunës së Mitrovicës: <https://kk.rks-gov.net/mitrovicееjugut/thirrja-per-subvencionim-kulture/> Dokumentet e kompletuara duhet të dërgohen personalisht ose me postë, në adresën e mëposhtme:

Komuna e Mitrovicës-Kati i parë, zyra pritëse

Rruga “Bedri Gjinaj”, 40,000 Mitrovicë

Procesi i pranimit, hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve, vlerësimit të aplikacioneve, kontraktimi, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendari tregues i zbatimit të ftesës është i detajuar në **Udhëzimet për aplikuesit (lu lutem konsultoni Udhëzuesin për aplikim).**

Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë ftesë publike, të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara të ftesës publike.

Të gjitha çështjet që lidhen me ftesën publike mund të sqarohen vetëm në mënyrë elektronike, duke dërguar e-mail në adresën: arber.hajra@rks-gov.net **5 ditë para përfundimit të thirrjes.**

Këtu mund të gjeni dokumentacionin përcjellës që duhet të plotësohet;

[Udhëzimet-për-Aplikantet-Kultura](#)

[F9 Formulari i Aplikacionit për projekt](#)

[F10-Formulari-i-propozim-buxhetit-për-OJQ Kultura](#)

[F11 Forma e deklaratës për financimin e dyfishte](#)

[F12 Formular i deklaratës së partneritetit](#)

[F13-Forma-e-deklaratës-së-projekteve-të-financuara-1](#)

[F14.-Deklaratë-mbi-aktivitetet-e-përshkruara-për-kontraktoret](#)

[Shpallje-për-anëtar-të-komisionit-për-Vleresimin-e-Projekteve-në-fushën-e-Kulturës](#)